

VENDIM
Nr. 780, datë 2.11.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“NDËRHYRJE REHABILITUESE NË ZONËN E MBROJTUR TË QENDRËS
HISTORIKE TË DHËRMIUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në zonën kadastrale nr. 1481, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 200 (dyqind) m² dhe sipërfaqe truall 270 (dyqind e shtatëdhjetë) m², që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje rehabilituese në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike të Dhërmiut”, miratuar me vendimin nr. 80, datë 13.4.2016, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “njësi shërbimi”, me një vlerë të përgjithshme 7 464 400 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 7 464 400 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës.

7. Pronarët e konfirmuar nga ZVRPP Vlorë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Vlorë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Vlorë, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
MARRJEN NË PERDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK , TË CILAT PREKEN NGA
"PROJEKTI PËR NDËRHYRJE REHABILITUESE NË ZONËN E MBROJTUR TË QENDRËS
HISTORIKE TË DHËRMIUT"

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m ²)		Çmimi lekë/m ²		Vlera lekë		SHËNIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Njesi	
1	Areti Zaho	1481	28		40.00		32,516	-	1,300,640.00	sipas vërtetimit të pronësisë
2	Thodhori Duni	1481	417/130	270.000	160.00	3,560	32,516	961,200	5,202,560.00	sipas regjistrit hipotekor
				270.00	200.0	3,560	32,516	961,200	6,503,200	7,464,400
Totali:				7,464,400						